



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 84 date 01/11/2002

**PER
NJE SHTESE NE VENDIMIN E KESHILLIT BASHKIAK NR.117
DT.09.10.2001 "MBI TRANSPORTIN QYTETES NE QYTETIN E
TIRANES"**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 10 pika 3/I, gërma "d", të Ligjit Nr.8308 dt.18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", neni 13, neni 14 dhe 22, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.142 dt.30.10.2001 "Për Vendosjen e Stacioneve të Reja në Linjat e Transportit Qytetës", pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Në pikën Nr.1 të këtij Vendimit Nr.117 dt.09.10.2001 "Për transportin qytetas në qytetin e Tiranës" të shtohen më poshtë

"Linja Nr.9 Qendër-Rruga "M. Keta" (Varreza Tufinë)-
Qendër"

"Linja Nr.10 Parku i Madh Kombëtar-Qendër

2. Në pikën Nr.2 të Vendimit Nr.117 dt.09.10.2001 të shtohen si më poshtë:

“Linja Nr.9 Qëndër-Rruga “M. Keta” (Varreza Tufinë)-Qëndër
“Linja Nr.10 Parku i Madh Kombëtar-Qëndër

3. Stacionet për linjat sipas pikës 1 të këtij Vendimi, të jenë si më poshtë:

-Linja “Qëndër-Rruga “M. Keta” (Varreza Tufinë)-Qëndër”

Qëndër (Sahati)-Poliklinika Qëndrore-Shkolla e Kuqe-Unazë-Shkolla “Cajupi”-Spitali-Rruga “Kongresi i Manastirit”-Oxhaku-Kryqëzimi me Rrugën e “Dibrës” (Akademia Ushtarake)-Fillimi i Rrugës “Myslym Keta”-Ura-Antibiotiku-Tufinë (pa marrë përpjetën në rrugën për varreza)

Segmenti në intersektimin të Rrugës së “Barrikadave” me Rrugën “Qemal Stafa” dhe atë të “Rrugës “Bardhyl” me rrugën “Qemal. Stafa” do të shoqërohet me tabelën “Rrugë për autobuz në kthim”, duke qenë se kjo rrugë aktualisht është me një sens lëvizjeje

-Linja “Parku i Madh Kombëtar-Qendër”:

Qendër-pas Selisë së Kuvendit të Shqipërisë-Shkolla “11 Janari” Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve-Kopshtit Zoologjik

Kthiminga Rruga “Myslym Shyri”, me stacione: Unaza – Sigurimet Shoqërore – Gjykata e Lartë (ose Telekom) – Qëndër

4. Ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve për zbatimin e këtij Vendimi
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Leonidha TOSKA

